VENDIM
Nr. 1087, datë 24.12.2020

PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2021[1]

(ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 13.1.2021[2])

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12, të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, "Për nomenklaturën e kombinuar të mallrave dhe tarifën e integruar doganore", të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2021, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Vendimi nr. 846, datë 24.12.2019, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2020", shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1.1.2021.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

---

[1] Përafruar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (EU) 2020/1577, amendim i Rregullores së Këshillit Evropian (EEC) nr.2658/87, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 361, datë 21.9.2020.

[2] Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 13.1.2021 bëhet ndryshimi:
Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 1087, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, në pjesën e dytë, seksioni VI, "Produktet e industrisë kimike apo të industrive të lidhjeve", kapitulli 30, "Produktet farmaceutike", kodi tarifor "3002 20 00 - Vaksinat për ilaç njerëzor, pa taksë -", ndryshohet dhe zëvendësohet me kodet tarifore, si më poshtë vijon:
"★ 3002 20 10 - - Vaksinat kundër koronavirusit të lidhur me SARS-in (speciet SARS-CoV), pa taksë -
★ 3002 20 90 - - Të tjera, pa taksë -".